

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.R., nga Viti, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të dëmtuarës N.H. dhe të akuzuarit A.R., e të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, P.nr.534/2017, datë 02.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të dëmtuarës N.H. dhe të akuzuarit A.R., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, P.nr.534/2017, datë 02.11.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Viti, me aktgjykimin P.nr.534/2017, të datës 02.11.2018, të akuzuarin A.R., e ka shpallë fajtor për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, e ka shpallë fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 800 € (tetëqind euro), të cilën shumë i akuzuari është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast mos pagesës i njëjti dënim konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së, do ti zëvendësohet me dënim burg në kohëzgjatje prej 40 ditësh, duke i llogaritur çdo ditë të kaluar në burg nga 20 €, do. E dëmtuara N.H. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40 €, gjithashtu në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan shtetit dhe atë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burgim efektiv.

-e dëmtuara N.H. dhe atë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më rëndë.

-po ashtu edhe i akuzuari A.R., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.38/2019, datë 2018.01.2019, ka propozuar që të aprovohen si të bazuara ankesat e prokurorit të shtetit dhe e të dëmtuarës, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, P.nr.534/2017, të datës 02.11.2018, ashtu që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv, ndërsa të refuzohet ankesa e të akuzuarit, si e pabazuar.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Prokurori i shtetit, sa i përket vendimit mbi dënimin në ankesë pretendon se, përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë këtë çështje penale e ka gjykuar drejtë dhe mbi bazën e fakteve të argumentuara, në seancë ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale. Mirëpo, prokurori i shtetit konsideron se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënim të merituar sipas ligjit, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me lëndime të rënda trupore, kështu që dënimin e zbuti deri në atë masë e cila bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe kufijtë e kësaj zbutje të përcaktuar me dispozitat ligjore. Rrethanat çfarë do qofshin ato as sesi në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që të ndikojnë në zbutjen e dënimit deri në këtë masë, ku të akuzuarit ti shqiptohet dënim minimal edhe atë me gjobë, në rastin konkret të gjitha rrethanat lehtësuese të

cekura sikurse në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, nuk kanë rëndësi që të zbutet deri nën minimumin e paraparë ligjor. Po ashtu e njëjta ka përmendur rrethanat rënduese duke mos i kushtuar fare rëndësi rrethanave rënduese duke mos i kushtuar fare kujdes rrethanave tjera, si pasojat që i ka shkaktuar të dëmtuarës, ku e dëmtuara, si këmbësore si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore, se po të vlerësoheshin këto rrethana në mënyrë të duhur, sigurisht se sanksioni penal do të ishte tjetër dhe më i ashpër, sepse dënimi i shqiptuar është shumë i ulët. Po ashtu se me dënimet e tilla nuk do të arrihet qëllimi i dënimit.

E dëmtuara N.H., sa i përket vendimit mbi dënimin pretendon se, pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk mund të merret si rrethanë për shqiptimin e një dënimi kaq simbolik, se i akuzuari pas kryerjes së veprës penale nuk është interesuar për gjendjen time shëndetësore, e as nuk ka kontaktuar me familjarët e saj çoftë direkt apo nëpërmjet njerëzve tjerë. Se pasojat e aksidenti ende i vuan, për çka është në trajtim të vazhdueshëm mjekësor. Pavarësisht këtyre rrethanave-lëndimit të rëndë trupor dhe heqjes së organit trupor, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar mekanikisht dispozitat ligjore për zbutjen e dënimit.

Po ashtu i akuzuari A.R., sa i përket vendimit mbi dënimin pretendon se, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka nënvlerësuar rrethanat lehtësuese që ndikojnë në matjen e dënimit, edhe pse nuk ka pasur ndonjë rrethanë rënduese, dhe se lëndimi i të dëmtuarës nuk është rrethanë që ndikon në matjen e dënimit, por është element objektiv i veprës penale dhe nga rrethanat lehtësuese shihet se dënimi është i lartë, se nuk e ka zbatuar nenin 75 të KPRK-së. Gjithashtu nëse marrim parasysh që është i moshës së re dhe se është i papunë, duke parë se dënimi i shqiptuar në vlerë prej 800 €, është i lartë dhe nuk është në gjendje ta paguaj sepse nuk ia mundëson gjendja ekonomike. I akuzuari pretendon se me një dënim të tillë nuk do të arrihet qëllimi i tij i paraparë me dispozita ligjore, e me një dënim me të butë do të arrihej qëllimi i dënimit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarës që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i ashpër me dhe pretendimet e të akuzuarit që ti shqiptohet një dënim më i butë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, në rastin konkret gjykata për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte para gjykatës së shkallës së parë, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë parasysh se veprat e këtij lloji janë të manifestuara me një numër më të madh dhe paraqesin rrezikshmëri të përgjithshme shoqërore si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës. Një vlerësim të këtillë të rrethanave lehtësueses e relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa nuk e trajton si rrethanë rënduese rrethanën e theksuar nga gjykata e shkallës së parë –dëmin e shkaktuar të dëmtuarës pasi në e njëjta është element inkriminues i veprës penale . Rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit dhe të dëmtuarës, nuk janë të bazuara, e po ashtu edhe rrethanat lehtësuese të pretenduara nga ana e të akuzuarit, nuk qëndrojnë, ngase të njëjtat sipas vlerësimit të kësaj gjykate kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, duke përfshirë edhe shkaktimit

të dëmit të dëmtuarës, prandaj duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë veçanërisht e re rënduese apo lehtësuese, të cilat do të kishin pasur ndikim në shqiptimin e një dënimi më të ashpër apo më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neni 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.15/19, datë 22.01.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq